



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

RAPORT
PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK TË REALIZUAR NGA MINISTRIA E
MBROJTJES PËR VITIN 2021

1. Përmbledhje ekzekutive

Gjatë vitit 2021, Ministria e Mbrojtjes ka realizuar planin e saj të konsultimit publik të akteve duke përmbyllur procedurën e konsultimit publik për 3 (tre) projektakte dhe ka nisur dhe zhvilluar procedurën e prokurimit publik për 1 (një) projektakt.

Të gjithë projektaktet e mësipërme ishin të parashikuara në Planin Vjetor të Konsultimit Publik, për vitin 2021.

Gjatë zhvillimit të procesit të konsultimit publik janë përdorur metoda të ndryshme në varësi të projektakteve. Kryesisht, duke patur në konsideratë situatën e krijuar me Covid-19 është zgjedhur që grupeve të interesit t'i drejtohem në rrugë elektronike dhe në raste të veçanta janë organizuar takime grupi pune duke respektuar masat anticovid.

Në tërësi ka pasur një rritje të numrit të personave të përfshirë në konsultim nëpërmjet dhënies së mendimeve/sugjerimeve. Ky fakt ka ndikuar në cilësinë e procesit të draftimit të projektakteve pasi shpeshherë sugjerimet e marra nga grupet e interesit kanë ndikuar pozitivisht në përmirësimin e draftit të projektaktit.

2. Analiza e konsultimeve të kryera gjatë vitit 2021

2.1. Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike

Ministria e Mbrojtjes, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, parashikoi në Planin Vjetor të Konsultimit Publik për vitin 2021 të zhvillonte konsultim publik për 9 projektakte (6 projektligje; 3 projektvendime). Informojmë se një pjesë e projektakteve të Ministrisë së Mbrojtjes bien në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe marrëveshje dypalëshe dhe shumëpalëshe, të cilat janë të përjashtuara nga konsultimi publik, në përputhje me përcaktimet e nenit 4 të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.


Për sa më sipër, Ministria e Mbrojtjes, gjatë vitit 2021 zhvilloi konsultim publik për aktet si më poshtë:

1. Projektligj “Për rezervat materiale të shtetit”;

2. Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9047, datë 10.07.2003 “Për shërbimin ushtarak në RSH”;
3. Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.13/2015 “Për policinë ushtarake në Forcat e Armatosura të RSH”;
4. Projektligj “Për tregtinë e produkteve që mund të përdoren për dënime kapitale, torturë ose dënime apo trajtime çnjerëzore, ose degraduese”.

2.1.1. Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?

Procesit të konsultimit publik iu nënshtruan 4 (katër) projektakte. Nga lista e projektakteve që u planifikuan t’i nënshtrohen konsultimit publik për vitin 2021, për 5 (pesë) projektakte procesi i konsultimit publik nuk u zhvillua për arsye objektive. Prosesi i konsultimit publik për këto projektakte është planifikuar të zhvillohet gjatë vitit 2022.



2.1.3 Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?

Për të gjitha projektligjet e konsultuara, Ministria e Mbrojtjes, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse brenda MM/SHPFA ka përgatitur raporte VNR, të cilat gjithashtu janë konsultuar duke u publikuar në RENJK.

2.1.4 Për sa akte në a) Programin Analitik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përfjashtimet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyet kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tilla)?

Për vitin 2021, në Ministrinë e Mbrojtjes, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1121, datë 30.12.2021 “Për miratimin e Programit të Përgjithshme Analitik të

projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2021”, ka planifikuar për të propozuar për miratim 38 (tridhjetë e tetë) projektakte, prej të cilave 6 (gjashtë) projektligje (16%) dhe 32 (tridhjetë e dy) projektvendime (84%). Gjatë gjithë vitit janë planifikuar të zhvillohen konsultime publike për 6 (nëntë) projektligje (100%) nga 6 (gjashtë) në total dhe 3 (tre) projektvendime (10%) nga 32 (tridhjetë e dy) në total.

Pjesa tjetër e projektligjeve bien në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe marrëveshje dypalëshe dhe shumëpalëshe, të cilat bazuar në nenin 4 të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” janë të përjashtuara nga konsultimi publik. Nga ana tjetër, ligji i mësipërm nuk përcakton detyrime për zhvillimin e konsultimit publik për projektvendime, me përjashtim të rasteve ku nëpërmjet tyre miratohen “*dokumente strategjike kombëtare*”.

Gjatë vitit 2021, u planifikua të propozohen për miratim 3 (tre) dokumente strategjike, për të cilët u parashikua të zhvillohet konsultim publik për të 3 (tre) dokumentet strategjike (100%).

Sa i përket projektakteve të parashikuara në PKIE, informojmë se për vitin 2021 ishin parashikuar 4 (katër) projektakte, prej të cilave për vetëm 1 (një) projektakt (25%) zhvillohet konsultimi publik, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

2.1.5. Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, rregullore etj.)?

Gjatë vitit 2021, procesit të konsultimit publik iu nënshtruan 4 (katër) projektligje.

2.1.6 A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?

Në përfundim të vitit 2021, është vënë re që ka përmirësim të situatës sa i përket angazhimit të strukturave në realizimin e procesit të konsultimit publik si dhe rritje të përfshirjes së grupeve të interesit nëpërmjet dhënies së komenteve dhe sugjerimeve mbi përmbajtjen e projektakteve, të cilat i nënshtrohen konsultimit publik. Ky fakt ka një ndikim të drejtpërdrejtë pozitiv në mbarëvajtjen e procesit të përgatitjes së projektakteve. Në krahasim me vitin paraardhës ka rritje të komenteve të marra, si dhe rritje të numrit të subjekteve të përfshira në konsultim publik.

2.2. Metodat e konsultimit

Për të zhvilluar konsultimet publike mbi projektaktet që do të propozohen për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Ministrave, nga ana jonë u përdoren këto metoda:

- i) Publikimi i draftit të projektligjit në Regjistrin Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimit;
- ii) Publikimi i draftit në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes (të gjitha komentet/sugjerimet mund të dërgohen në adresën e emailit të hapur për këtë qëllim: konsultimi.publik@mod.gov.al);
- iii) Zhvillimi i takimeve publike me grupet e interesit.

Konkretisht:

Projektaktet, të cilat u publikuan në Regjistrin Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimit dhe faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes janë:

1. Projektligj “Për rezervat materiale të shtetit”;
2. Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9047, datë 10.07.2003 “Për shërbimin ushtarak në RSH”;
3. Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.13/2015 “Për policinë ushtarake në Forcat e Armatosura të RSH”;
4. Projektligj “Për tregtinë e produkteve që mund të përdoren për dënime kapitale, torturë ose dënime apo trajtime çnjerëzore, ose degraduese”.

Projektaktet, për të cilat u zhvilluan takime, krahas publikimit në Regjistrin Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimit dhe faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes janë si më poshtë:

- Projektligji “Për rezervat materiale të shtetit”;

2.2.1. Cilat ishin metodat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistrin elektronik, postën elektronike, faqet e internetit, takimet publike, komitetet këshilluese, etj.)

Duke marrë në konsideratë edhe situatën e krijuar nga Covid-19, metoda më e përdorur e konsultimit ka qenë RENJK dhe posta elektronike, të cilat janë përdorur në çdo proces konsultimi publik.

2.2.2. Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?

Metoda që gjeneroi më shumë të dhëna është komunikimi me shkrim me grupet e interesit, të cilët dërguan komente dhe sugjerime për projektaktet e konsultuara. Në total, me anë të kësaj metode janë mbledhur 22 (njëzet e dy) komente dhe sugjerime. Ndërkohë, nga publikimi në RENJK dhe në faqen zyrtare nuk kemi marrë asnjë koment.

2.2.3. A organizoi ministria gjithashtu disa konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?

Po, konsultimet paraprake në faza të hershme (konkretisht, para hartimit të draftit të projektaktit) janë zhvilluar në dy raste:

Së pari, sa i përket projektligjit “Për rezervat materiale të shtetit”, ku konsultimi nisi me organizimin e një takimi me operatorët ekonomikë, pas marrjes së komenteteve të të cilëve u vijua me përgatitjen e draftit.

Së dyti, në rastin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 13/2015 “Për Policinë Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, ku anëtarët e grupit

të punës, të ngritur me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes organizuan një takim paraprak me përfaqësues nga struktura të ndryshme ushtarake brenda FARSH dhe MM, para përgatitjes së draftit paraprak të projektligjit.

Gjithashtu, konsultim paraprak (në fazë të hershme, por pas përgatitjes së draftit) është zhvilluar edhe për projektligjin “Për tregtimin e produkteve që mund të përdoren për dënime kapitale, torturë ose dënime apo trajtime çnjerëzore ose degraduese”, drafti paraprak i të cilit ju dërgua fillimisht Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si dhe Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, e më tej u dërgua për vlerësim pranë shërbimeve të Komisionit Evropian.

2.3. Kohëzgjatja e konsultimeve

2.3.1. Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditët e kërkuara? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes?

Afati ligjor për minimumin prej 20 ditësh është respektuar në çdo procedurë konsultimi publik. Periudha më e gjatë e kohëzgjatjes së konsultimit publik ka qenë për projektligjin “Për rezervat materiale të shtetit”, i cili ka zgjatur 15 (pesëmbëdhjetë) muaj. Ndërsa, periudha më e shkurtër e konsultimit publik i takon projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9047, datë 10.07.2003 “Për shërbimin ushtarak në RSH”, i cili ka zgjatur 4 (katër) muaj.

2.3.2. Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?

Në çdo rast, konsultimet publike kanë qëndruar të hapura për të paktën 30 ditë. Afati mesatar për kohëzgjatje e konsultimit publik është 10 (dhjetë) muaj. Përgjatë, për nisma që janë shtrirë përtej një viti kalendarik, procesi i konsultimit publik ka zgjatur për një afat më të gjatë.

2.3.3. A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Po, ka dukshëm një përmirësim në raport me përfshirjen e grupeve të interesit me procesin e ofrimit të komenteve dhe sugjerimeve mbi përmbajtjen e projektakteve, të cilat i nënshtrohen konsultimit publik. Ky fakt ka një ndikim të drejtpërdrejtë pozitiv në mbarëvajtjen e procesit të përgatitjes së projektakteve.

2.4. Palët e interesit të përfshira

1.4.1 Sa palë interesi të jashtme morën pjesë në grupet e punës për hartimin e akteve? Sa eksperte ishin në tryeza?

Kryesisht, në grupet e punës për hartimin e akteve kanë marrë pjesë vetëm personeli i Ministrisë së Mbrojtjes. Pavarësisht kësaj, për projektaktet që kanë inpakt të drejtpërdrejtë tek grupet e interesit jashtë Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë janë organizuar takime publike. Në njërin prej takimeve të zhvilluara (për projektligjin “Për

rezervat materiale të shtetit” morën pjesë 2 (dy) pjesëmarrës nga 3 (tre) operatorë ekonomikë të ftuar.

1.4.2 Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individual, OSHC, kompani, etj.)

Për shkak se projektligji “Për rezervat materiale të shtetit” përcakton detyrime për operatorët ekonomikë, në takimin e zhvilluar kishin pjesëmarrës nga ky sektor.

1.4.3 Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultime të hapura të bëra për projekt-akte në vitin e caktuar?

Gjatë vitit 2021, në proceset e konsultimit publik kanë marrë pjesë 27 (njëzet e shtatë) subjekte. Sqarojmë që nga ana jonë komentet janë konsideruar si të ardhura nga struktura/personi juridik privat, çka do të thotë që numri i personave fizikë të përfshirë në këtë proces është shumë herë më i lartë edhe pse përlllogaritja e numrit të saktë është e pamundur. Gjithashtu, sqarojmë që për njërin prej projektakteve procesi nuk ka përfunduar. Për këtë arsye nuk përfshihet në përlllogaritje.

1.4.4 Cila ishte struktura e kontribuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?

Të gjithë personat kontribues ishin përfaqësues të personave juridikë publik/privat që preken drejtpërdrejtë nga parashikimet ligjore të projektakteve që i janë nënshtruar konsultimit publik.


2.5. Rekomandimet dhe komentet e marra

2.5.1. Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?

Gjatë vitit 2021, kemi mbledhur 22 (njëzet e dy) komente dhe sugjerime nga të gjitha metodat e konsultimit publik të përdorura.

2.5.2. Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?

Prej 22 komenteve/sugjerimeve të mbledhura: 11 (njëmbëdhjetë) u pranuan plotësisht, 2(dy) u pranuan pjesërisht dhe 9 (nëntë) u refuzua.



2.5.3. Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?

Në total, gjatë këtij viti vihet re një rritje i numrit të komenteve/sugjerimeve të marra dhe të pranuar nga ana jonë.

2.5.4. Cilat janë përfundimet/rezultatet kryesore nga procesi i konsultimit publik për periudhën e fundit?

Në tërësi, procesi i konsultimit publik po përmirësohet në drejtim të evidentimit të aktorëve që mund të preken nga nisma ligjvënëse dhe drejt gjithëpërfshirjes së grupeve të interesit në këtë proces.

2.5.5. Ndarja e praktikave më të mira nga procesi i konsultimit publik për periudhën e fundit

Një nga praktikat më të mirat të vitit 2021 janë projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9047, datë 10.07.2003 “Për shërbimin ushtarak në RSH” dhe projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.13/2015 “Për policinë ushtarake në Forcat e Armatosura të RSH”, të cilat u konsultuan në një masë të madhe me subjektet do të preken drejtpërdrejtë nga hyrja në fuqi e tyre. Komentet dhe sugjerimet e tyre, të ilustruara me shembuj konkret ishin shumë të vlefshme gjatë fazës së draftimit të këtyre projektligjeve.

2.6. Rezultatet e raporteve të konsultimeve

2.6.1 Sa raporte konsultimesh publikoi ministria?

Gjatë vitit 2021, Ministria e Mbrojtjes publikoi në Regjistrin Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik 4 (katër) projektakte.

2.6.2 Nëse disa nuk u botuan, cilat janë arsyet?

Nuk kemi raporte konsultimi publik të papublikuara.

2.7 Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksën e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik (Jepni informacion për rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit, subjekt të konsultimeve publike, bazuar në pikët e rezultateve në Shtojcën 5c)

Gjatë vitit 2021, u zhvillua procesi i konsultimit publik për 4 (katër) projektakte, nga të cilat procesi u përmbyll për 3 (tre) prej tyre. Për 1 (një) projektakt, procesi i konsultimit publik nuk ka përfunduar ende.

Sa i përket 3 projektakteve, bëjmë me dije se është respektuar me rigorozitet procedura dhe kërkesat e ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”:

- projektligjet janë publikuar në RENJK;
- është dhënë informacion i mjaftueshëm lidhur me konsultimin e gjerë me grupet e interesit;
- janë ruajtur prova të mjaftueshme për reagimet e tyre;
- në draftin e ri të projektligjit pasqyrohet një shkallë e mirë e reflektimit të reagimit të palëve të interesuara;

Për këtë arsye, Ministria e Mbrojtjes është vetëvlerësuar me pikët maksimale (8) për tre projektligjet për të cilët procesi i konsultimit publik ka përfunduar.

3. Sfidat, rreziqet kryesore dhe mundësitë për të ardhmen

Sfida kryesore në kuadër të konsultimit publik mbetet nxitja e publikut për të rritur pjesëmarrjen nëpërmjet dhënies së mendimeve/sugjerimeve, në proceset e konsultimit publik. Për të bërë të mundur rritjen e pjesëmarrjes së publikut, kërkohet angazhimi i të gjitha institucioneve shtetërore, të përfshira në procesin e konsultimit publik.

